



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2022:141448
Datë: 27.01.2025
Numri i dokumentit: 06759527
C.nr.2303/2022

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN - Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Baki Shigjeqi, duke vendosur në çështjen kontestimore të paditësve: V.Sh. me numër personal V.B.1. me numër personal V.B.2. me numër personal Sh.G. me numër personal V.J. me numër personal, që të gjithë nga Prizreni, të cilët sipas autorizimit i përfaqëson B.K. dhe F.G. të dy avokat nga Prizreni, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit – Drejtoria Komunale e Arsimit, me objekt kontesti pagesa mbi bazën e përqindjes së inflacionit, vlera e kontestit 1,910.13 euro, jashtë seance, me datë 27.01.2025 mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET pjesërisht e bazuar kërkesëpadia e paditësve: V.Sh., V.B.1., V.B.2., Sh.G. dhe V.J. që të gjithë nga Prizreni. **DETYROHET** e paditura Komuna e Prizrenit – Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditësit të kompensohen në emër të pagesës shtesë mbi bazën e inflacionit për periudhën, dhe atë:

a) Paditësja V.Sh.

1. Për periudhën kohore 01.07.2019 - 31.12. 2019 në shumën prej 68.23 euro;
 2. Për periudhën kohore 01.01.2020 – 31.12.2020, në shumën prej 1.20 euro;
 3. Për periudhën kohore 01.01.2021 – 31.12.2021, në shumën prej 171.84 euro,
- Në shumën e përgjithshme prej 241.27 euro me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, e cila fillon të rrjedh nga data e paraqitjes së padisë (13.07.2022), e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktvendimi, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

b) Paditësen V.B.1.

4. Për periudhën kohore 01.07.2019 – 31.12.2019 në shumën prej 63.66 euro;
 5. Për periudhën kohore 01.01.2020 – 31.12.2020, në shumën prej 1.20 euro;
 6. Për periudhën kohore 01.01.2021 – 31.12.2021, në shumën prej 160.32 euro,
- Në shumën e përgjithshme prej 224.52 euro me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, e cila fillon të rrjedh nga data e paraqitjes së padisë (13.07.2022), e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktvendimi, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

c) Paditës V.B.2.

7. Për periudhën kohore 01.06.2019 – 31.12.2019 në shumën prej 68.23 euro;
 8. Për periudhën kohore 01.01.2020 – 01.12.2020, në shumën prej 1.08 euro;
 9. Për periudhën kohore 01.01.2021 – 31.12.2021, në shumën prej 171.84 euro,
- Në shumën e përgjithshme prej 241.15 euro me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, e cila fillon të rrjedh nga data e paraqitjes së padisë (13.07.2022), e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktvendimi, nën kërcënim të përmbarrimit me dhunë.

d) Paditësen Sh.G.

10. Për periudhën kohore 01.06.2019 – 31.12.2019 në shumën prej 43.27 euro;
 11. Për periudhën kohore 01.01.2020 – 01.12.2020, në shumën prej 0.72 euro;
 12. Për periudhën kohore 01.01.2021 – 31.12.2021, në shumën prej 108.99 euro,
- Në shumën e përgjithshme prej 152.98 euro me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, e cila fillon të rrjedhë nga data e paraqitjes së padisë (13.07.2022), e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktvendimi, nën kërcënim të përmbarrimit me dhunë.

e) Paditësin V.J.

13. Për periudhën kohore 01.01.2021 – 31.12.2021 në shumën prej 171.84 euro, me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, e cila fillon të rrjedhë nga data e paraqitjes së padisë (13.07.2022), e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktvendimi, nën kërcënim të përmbarrimit me dhunë.

II. REFUZOHET e pa bazuar pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësve, përtej shumës së gjykuar sikur në pikën I. të këtij dispozitivi në emër të pagesës mbi bazën e përqindjes së inflacionit dhe atë për:

- Paditësen V.Sh. shuma prej 270.23 euro,
- Paditësen V.B.1. shuma prej 284.58 euro,
- Paditësen V.B.2. shuma prej 130.61 euro,
- Paditësen Sh.G. shuma prej 169.49 euro dhe
- Paditësin V.J. shuma prej 23.76 euro.

III. DETYROHET e paditura Komuna e Prizrenit - Drejtoria e Arsimit, që paditësve në emër të shpenzimeve të procedurës, t'ia paguaj shumën prej 342.00 euro, të gjitha këto në afat prej 7 ditëve, nga dita e marrjes së aktgjykimit, e nën kërcënim të përmbarrimit.

A r s y e t i m

Paditësit V.Sh., V.B.1., V.B.2., Sh.G. dhe V.J. që të gjithë nga Prizreni, në këtë gjykatë me datë 13.07.2022, përmes të autorizuarve të tyre B.K. dhe F.G. të dy avokat nga Prizreni, kanë

ushtruar padi kundër të paditurës Komuna e Prizreni – Drejtoria Komunale e Arsimit, për pagesën mbi bazën e përqindjes së inflacionit.

Në padi kanë theksuar se në nenin 35 par.10 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, është paraparë që për çdo vit të përcillet shkalla e inflacionit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës dhe përqindja e inflacionit të futet në pagë. Shuma për kompensimin sipas inflacionit në vend për periudhën kohore për vitet 2017, 2018, 2019, 2020, 2021, paditëseve ju takon shuma si në vijim: V.Sh. shumën prej 511.50 euro, V.B.1. shumën prej 509.10 euro, V.B.2. shumën prej 371.76 euro, Sh.G. shumën prej 322.47 euro dhe V.J. shumën prej 195.60 euro. Po ashtu kanë theksuar se edhe pas kërkesës së vazhdueshme për këto kompensime pranë të paditurës, deri më tani nuk kanë marrë përgjigje. Pasi që e paditura nuk e ka përmbushur kërkesën e paditësve vullnetarisht, gjykatës i kanë propozuar që të merr aktgjykim dhe ta aprovojë kërkesëpadinë në tërësi si të bazuar. Shpenzimet e procedurës kontestimore i kanë kërkuar, për përpilimin e padisë shumën prej 312.00 euro si dhe taksën gjyqësore.

E paditura Komuna e Prizrenit – Drejtoria Komunale e Arsimit, përmes të autorizuarës së saj, në këtë gjykatë ka paraqitur përgjigje në padi me datë 08.08.2022, ku ka theksuar se e kundërshton në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë si të pa bazuar. Pretendimet e paditësve se ju takon kompensimi i inflacionit është në kundërshtim me nenin 2 paragrafi 1.1 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, sepse në këtë dispozitë shkruan qartë se përfitues të të gjitha beneficioneve që rrjedhin nga Kontrata Kolektive e Arsimit janë vetëm anëtarët e Sindikatës së Arsimit-SBASHK-ut. Paditësit ushtrojnë padi në gjykatë për realizimin e të drejtave të tyre pa përfunduar procedura administrative, sepse nuk i ka vazhduar procedurat në Inspektoratin e Punës në Prizren. Padia është në kundërshtim të plotë me nenin 56 të Ligjit të Punës, sepse me këtë dispozitë parashihet decidivisht se çka përfshinë paga shtesë. Andaj çështja e pagës shtesë për shkak të inflacionit siç pretendojnë paditësit nuk lejohet me ligjin e punës, i cili ligj në këtë rast është ligj i veçantë dhe e rregullon çështjen e pagës shtesë dhe rrjedhimisht ligji i veçantë në çdo çështje ka epërsi kundrejt çdo ligji apo akti nënligjor. Pretendimet e paditësve se ju takojnë beneficioni nga Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë, janë në kundërshtim me nenin 90 paragrafët 1.1 dhe 1.2 të Ligjit të Punës të R. Kosovës Nr.03/L-212, sepse sipas këtyre dispozitave marrëveshja kolektive lidhet në mes të organizatës së punëdhënësve dhe organizatës së të punësuarve, ndërsa në këtë rast Komuna e Prizrenit është punëdhënësi dhe nuk mund të obligohet në përmbushjen e kësaj kontrate, pa qenë palë nënshkruese e kësaj kontrate. Tutje ka shtuar se e drejta për kompensim të inflacionit për vitin 2017 dhe deri më ditën e parashtrimit të padisë është parashkruar, sipas nenit 353 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve kjo e drejtë është parashkruar. Në fund gjykatës i ka propozuar që padinë dhe kërkesëpadinë e paditësve ta refuzoj në tërësi si të pabazuar. Shpenzimet e procedurës kontestimore nuk i ka kërkuar.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin 398 dhe nenin 399 të LPK, gjeti se kërkesëpadia e paditësve është pjesërisht e themeltë, andaj pa caktuar seancë gjyqësore, vendosi lidhur me kërkesëpadinë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga parashtrimet e palëve ndërgjyqësve të paraqitura me padi dhe përgjigjes në padi, gjykata ka gjetur se nga vërtetimet të lëshuara nga drejtori i shkollës ku paditësit punojnë vërtetohet fakti se paditësit janë në marrëdhënie pune tek e paditura në SH.F.M.U “Ibrahim Fëmiu” në Prizren, dhe realizojnë paga bazë mujore , paditësja V.Sh. në shumën prej 421.20 euro, paditësja V.B.1. në shumën prej 393.00 euro, paditësja V.B.2. në shumën prej 421.20 euro, paditësja Sh.G. në shumën prej 267.15 euro, V.J. në shumën prej 421.20 euro. Po ashtu gjykata bazuar në Indeksin e Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës ka vërtetuar se shkalla e inflacionit për vitin 2019 ka qenë 2.7%, për vitin 2020 ka qenë 0.2%, dhe për vitin 2021 ka qenë 3.4%.

Gjykata provave të lartcekura iu fali besimin e plotë ngase është bërë e besueshme fuqia provuese e tyre, duke u bazuar edhe në nenin 329 par.1 të LPK-së, i cili përcakton se: *“Shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të”*.

Gjykata gjen se në rastin në fjalë duhet të zbatohen dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë (KKAK), të nënshkruar në mes të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës, e cila ka hyrë në fuqi me datë 18.04.2017 dhe asaj të datës 22.01.2021, ku në nenin 35 par.10 parashihet se *“për çdo vit të përcillet shkalla e inflacionit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës dhe përqindja (%) e inflacionit të futet në pagë”*, si dhe duke u bazuar edhe në mendimin juridik të gjykatës Supreme të Kosovës nr.214/2023 date 09.10.2023 ku në pikën II parashihet që *“punëtorët në bazë të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017, dhe Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 22.01.2021, kanë të drejtë që në pagën e tyre të futet përqindja e inflacionit marrë për bazë shkallën e inflacionit çdo vit, sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës, ashtu siç është përcaktuar me nenin 35, pika 10 të këtyre marrëveshjeve”* ashtu që gjykata erdhi në përfundim se në rastin konkret paditëseve u takon e drejta në pagesën mbi bazën e përqindjes së inflacionit, si në pikën I. të dispozitivit të këtij aktgjykimi dhe atë sipas përllogaritjes së bërë në këtë mënyrë:

Për paditësen V.Sh.

- Për periudhën Korrik -Dhjetor 2019, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 2.7%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditësit në vitin 2019 ka qenë 421.20 euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë është 68.23 euro ($421.20 * 2.7\% = 11.37 * 6$ muaj = 68.23 euro);
- Për periudhën Janar - Dhjetor 2020, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 0.2%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditësit në vitin 2020 ka qenë 421.20 euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë është 10.10 euro ($421.20 * 0.2\% = 0.84 * 12$ muaj = 10.10 euro), mirëpo meqenëse gjykata bazuar në nenin 2, par.1 të LPK-së, është e lidhur me kërkesën e palës, dhe pala paditëse në kërkesëpadi ka kërkuar që të aprovohet shuma prej 1.20 euro, në emër të inflacionit për

vitin 2020, gjykata vendosi sipas kërkesës së palës duke e aprovuar kërkesën për këtë periudhë në lartësinë e kërkuar nga pala paditëse.

- Për periudhën Janar - Dhjetor 2021, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 3.4%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditëses në vitin 2021 ka qenë 421.20 euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë është 171.84 euro ($421.20 * 3.4\% = 14.32 * 12 \text{ muaj} = 171.84 \text{ euro}$).

Për paditësin V.B.1.

- Për periudhën Korrik -Dhjetor 2019, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 2.7%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditësit në vitin 2019 ka qenë 393.00 euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë është 63.66 euro ($393.00 * 2.7\% = 10.61 * 6 \text{ muaj} = 63.66 \text{ euro}$);
- Për periudhën Janar - Dhjetor 2020, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 0.2%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditësit në vitin 2020 ka qenë 393.20 euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë është 10.10 euro ($393.00 * 0.2\% = 0.78 * 12 \text{ muaj} = 9.43 \text{ euro}$), mirëpo meqenëse gjykata bazuar në nenin 2, par.1 të LPK-së, është e lidhur me kërkesën e palës, dhe pala paditëse në kërkesëpadi ka kërkuar që të aprovohet shuma prej 1.20 euro, në emër të inflacionit për vitin 2020, gjykata vendosi sipas kërkesës së palës duke e aprovuar kërkesën për këtë periudhë në lartësinë e kërkuar nga pala paditëse.
- Për periudhën Janar - Dhjetor 2021, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 3.4%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditëses në vitin 2021 ka qenë 393.00 euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë është 160.32 euro ($393.00 * 3.4\% = 13.36 * 12 \text{ muaj} = 160.32 \text{ euro}$).

Për paditësin V.B.2.

- Për periudhën Korrik -Dhjetor 2019, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 2.7%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditësit në vitin 2019 ka qenë 421.20 euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë është 68.23 euro ($421.20 * 2.7\% = 11.37 * 6 \text{ muaj} = 68.23 \text{ euro}$);
- Për periudhën Janar - Dhjetor 2020, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 0.2%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditësit në vitin 2020 ka qenë 421.20 euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë është 10.10 euro ($421.20 * 0.2\% = 0.84 * 12 \text{ muaj} = 10.10 \text{ euro}$), mirëpo meqenëse gjykata bazuar në nenin 2, par.1 të LPK-së, është e lidhur me kërkesën e palës, dhe pala paditëse në kërkesëpadi ka kërkuar që të aprovohet shuma prej 1.08 euro, në emër të inflacionit për vitin 2020, gjykata vendosi sipas kërkesës së palës duke e aprovuar kërkesën për këtë periudhë në lartësinë e kërkuar nga pala paditëse.
- Për periudhën Janar - Dhjetor 2021, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 3.4%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditëses në vitin 2021 ka qenë 421.20 euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë është 171.84 euro ($421.20 * 3.4\% = 14.32 * 12 \text{ muaj} = 171.84 \text{ euro}$).

Për paditësen Sh.G.

- Për periudhën Korrik -Dhjetor 2019, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 2.7%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditësit në vitin 2019 ka qenë 267.15 euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë është 43.27 euro ($267.15 * 2.7\% = 7.21 * 6$ muaj = 43.27 euro);
- Për periudhën Janar - Dhjetor 2020, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 0.2%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditësit në vitin 2020 ka qenë 267.15 euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë është 10.10 euro ($267.15 * 0.2\% = 0.53 * 12$ muaj = 6.41 euro), mirëpo meqenëse gjykata bazuar në nenin 2, par.1 të LPK-së, është e lidhur me kërkesën e palës, dhe pala paditëse në kërkesëpadi ka kërkuar që të aprovohet shuma prej 0.72 euro, në emër të inflacionit për vitin 2020, gjykata vendosi sipas kërkesës së palës duke e aprovuar kërkesën për këtë periudhë në lartësinë e kërkuar nga pala paditëse.
- Për periudhën Janar - Dhjetor 2021, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 3.4%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditëses në vitin 2021 ka qenë 267.15 euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë është 108.99 euro ($267.15 * 3.4\% = 9.08 * 12$ muaj = 108.99 euro)

Për paditësin V.J.

- Për periudhën Janar - Dhjetor 2021, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 3.4%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditëses në vitin 2021 ka qenë 421.20 euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë është 171.84 euro ($421.20 * 3.4\% = 14.32 * 12$ muaj = 171.84 euro)

Bazuar në të lartcekurat, gjykata duke iu referuar nenit 398 të LPK-së, ku parashihet që: *“kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”*, ka vendosur si në pikën I. të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Ndërsa sa i përket pjesës refuzuese, gjykata vendosi jashtë seancës gjyqësore edhe atë në kuptim të nenit 399 paragrafi 1 të LPK-së, ku parashihet që *“kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadisë, atëherë ajo do të jep vendimin meritor me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadi”*, pasi që gjykata e vlerësoi të bazuar pretendimin e palës së paditur lidhur me parashkrimin e kërkesës së palës paditëse. Kështu, sipas nenit 87 të LP-së shprehimisht theksohet që *“të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”*. Në këtë drejtim, paditësit padinë pranë kësaj gjykate e kanë parashtruar më datë 13.07.2022. Rrjedhimisht, duke vlerësuar afatin 3 vjeçar për parashkrimin e kërkesës në fjalë, gjykata erdhi në përfundim se paditësve iu ka parashkruar pjesa e kërkesës nga viti 2017 deri me datë 30.06.2019.

Me paraqitjen e padisë, në gjykatë më datë 13.07.2022 në kuptim të nenit 369 të LMD-së, është ndërprerë parashkrimi për periudhën 01.07.2019 e deri më 31.12.2021, edhe përkundër faktit se padia është parashtruar më datë 13.07.2022 gjykata vlerëson se parashkrimi është ndërprerë në tërësi për muajin Korrik 2019, pasi që parashkrimi për kërkesën e paditësve për muajin Korrik 2019 ka filluar të rrjedh vetëm pasi që të njëjtët kanë pranuar pagën e këtij muaji, e cila realizohet në fund të muajit, rrjedhimisht të njëjtit pas pranimit të kësaj page janë njoftuar se e paditura nuk e ka përmbushur detyrimin për kompensimin e inflacionit për muajin Korrik 2019 dhe nga fillimi i muajt vijues saktësisht Gusht 2019, të njëjtit kanë mundur të kërkojnë përmbushjen e detyrimit, në bazë të nenit 342 të LMD-së, me të cilin parashihet që *“parashkrimi fillon të rrjedhë ditën e parë pas ditës kur kreditori të ketë pasur të drejtë të kërkojë përmbushjen e detyrimit, në qoftë se me ligj për raste të veçanta nuk është parashikuar diçka tjetër”*. Më konkretisht, sipas llogaritjes së gjykatës, një kërkesë e tillë është parashkruar nga data 01.01.2017 deri me datë 30.06.2019.

Gjithashtu gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke ia njohur paditësve kompensimin mbi bazën e përqindjes së inflacionit në pagën bazë të cilën e realizojnë paditësit duke u bazuar në vërtetimet e lëshuara nga punëdhënësi dhe jo siç është kërkuar nga paditësit pasi që kjo shumë përfshinë në vete edhe shtesat në pagë që i realizojnë paditësit, andaj mbi këtë bazë gjykata refuzoi të pabazuar kërkesën e paditësve sikurse në pikën nën II. të dispozitivit të aktgjykimit dhe atë sa i përket parashkrimit të kërkesës (nga data 01.01.2017 deri me datë 31.05.2019) si dhe duke e minusuar shumën e kërkuar në raport me pagën bazë që paditësit realizojnë dhe atë për paditësen V.Sh. shuma prej 270.23 euro, për paditësen V.B.1. shuma prej 284.58 euro, për paditësen V.B.2. shuma prej 130.61 euro, për paditësen Sh.G. shuma prej 169.49 euro dhe për paditësin V.J. shuma prej 23.76 euro.

Gjykata vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke aprovuar shumën përkatëse dhe duke llogaritur kamatën ligjore si në dispozitiv, bazuar në nenin 382 par. 1 dhe 2 të LMD-së, duke e llogaritur të njëjtën nga dita e parashtrimit të padisë në këtë gjykatë (13.07.2022), bazuar në Mendimin Juridik për Kamatën të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 265/2020 të datës 02.12.2020, pasi që në rastin konkret pala e paditura është vonuar në përmbushjen e obligimit ndaj palës paditëse.

Vendimin që pala e paditur t'i bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 449, 452 dhe 453.2 të LPK-së, sipas Tarifës së Odës së Avokatëve, lartësia e shpenzimeve i referohet përpilimit të padisë në shumën prej 312.00 euro dhe taksës gjyqësore në shumën prej 30.00 euro, përkatësisht shumën e përgjithshme prej 342.00 euro.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në pajtim me dispozitat e nenit 398 dhe nenit 399 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE PRIZREN
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL
2022:141448, 27.01.2025

G j y q t a r i

Baki Shigjeqi

Numri i lëndës: 2022:141448
Datë: 27.01.2025
Numri i dokumentit: 06759527

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve nga dita e pranimi pranë Gjykatës së Apelit, përmes kësaj Gjykate. Ankesa duhet të paraqitet në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.